

Seminari i Fushës Frojdiane në Shqipëri  
Rrethi Lakanian Shqiptar

Urgjenca e ankthit te fëmija  
Geert Hoornaert



4 Maj 2019  
9h00-17h30  
Kryqi Kuq Shqiptar  
Rruga Pjetër Budi  
Tiranë

**ASSOCIATION DE LA FONDATION DU CHAMP FREUDIEN**

*74, rue d'Assas - 75 006 Paris*

*Tél : 01 45 48 56 72 – Fax : 01 45 48 79 38*

**SEMINARI I FUSHES FROJDIANE NE SHQIPERI**

***Paraqitje e përgjithshme***

Seminari do të mbahet nga lektori i Fushës Frojdiane, **Geert Hoornaert** anëtar i NLS (*New Lacanian School*) dhe i Shoqatës Botërore të Psikanalizës (A.M.P.). Ky cikël seminaresh organizohet nga Sekretariati i Fushës Frojdiane për Europën Lindore.

Sesioni i dytë do të zhvillohet në **4 Maj** nga **Geert Hoornaert**, psikanalist në Belgjikë

**Regjistrimet** kryhen në adresën elektronike ***seminaret\_e\_psikanalizes@nyjelakim.net***

***Donacioni për seminarin – 2000 lekë.***

Për më shumë informacione vizitoni faqen tonë zyrtare **[www.nyjelakim.net](http://www.nyjelakim.net)**

Ky cikël seminaresh është i akredituar nga Q.K.E.V.

# Urgjenca e ankthit te fëmija

## ARGUMENTI

Rasti i famshëm i Hansit të vogël- analizë e një fobie tek një fëmijë pesë vjeçar e realizuar nga Frojdi (1909) - është ripërpunuar dhe komentuar shumë herë nga Jacques Lacan-i. Ky rast i analizuar në hollësi, i lejoi Frojdit, ashtu siç e pohon ai vetë - të “ depërtojë në konteksturën e një fobie ”. Ai do të nxjerrë prej saj dy elementë thelbësorë, të cilët janë edhe sot shumë aktual dhe që na mundësojnë të kuptojmë në mënyrë më të hollësishme këtë simptomë e cila ndeshet shpesh tek fëmijët e vegjël : frika përkundrejt një objekti (një kafshë, stuhia, errësira...). Intensiteti i kësaj frike është i tepruar dhe nuk shpjegohet vetëm nëpërmjet objektit që e frymëzon. Do të jetë prurja e parë frojdiane : ashtu sikurse fëmija frikësohet përkundrejt një objekti që nuk është domosdoshmërisht i rrezikshëm në vetvete (kali, shkolla, topi...) dhe nuk është as domosdoshmërisht shumë i pranishëm në mjedisin e tij të përditshëm (krokodili, tigri, gjigandi...), kjo frikë mund të jetë e zhvendosur : burimi i saj, objekti i saj “ i vërtetë ”, do të ishte rrjedhimisht gjetiu.

Kjo do të ndikojë që Frojdi ta konceptojë këtë *frikë* fobike si një mbrojtje kundër *angështisë*, shkaktarja kryesore që e brenkos realisht fëmijën, përpara se fobia, e përkufizuar si frikë, të shpërthejë. Objekti i kësaj angështie është edhe më i mistershëm, më i vështirë për tu kuptuar duke nisur nga vetë fëmija. Objekti fobik do ti jepte atëherë një formë dhe një objekt kësaj angështie e cila në vetvete nuk i përmban, duke i lejuar fëmijës ta mbajë angështinë marg, falë frikës. Ky objekt fobik i cili mbart një emër dhe një imazh (psh. kali) trajton kësaj angështinë që nuk i mbart këto dy elementë. Ky objekt i lejon fëmijës ta zbusë angështisë, e ta mbajë atë sa më larg, nën kontroll duke vendosur një vijë kufitare si dhe duke vendosur pika referuese aty ku angështia bëhet e pakontrollueshme.

Frojdi dhe Lacan-i shtrojnë atëherë çështjen e burimeve të kësaj angështie e cila gjallon pas frikës dhe që shpjegon urgjencën e zgjidhjes fobike. Për cilën angështi po flasim dhe çfarë vihet në lojë tek kjo angështi? Në cilën situatë gjendet fëmija përderisa një urgjencë e shtyn atë drejt një përgjigjeje fobike? Këtu studimi i hollësishëm i rasteve të fëmijëve dhe situatës së tyre familjare, të thënieve të tyre dhe të prindërve të tyre, na mundëson t’i japim përgjigje. Për sa i përket rastit të Hansit të vogël, Frojdi dhe Lacan-i do të nënvizojnë dy elementë të cilët do të shkaktojnë përgjigjen fobike nëpërmjet angështisë që këta elementë përftojnë. Çfarë mund të bësh me këto ndjesi të çuditshme që burojnë në trupin e tij? Fobia do të jetë një përgjigje fillestare përballë angështisë, duke e transformuar këtë angështi në një ndjenjë frike. Studimi i hollësishëm i rastit të Frojdit ngelet i rëndësishëm sepse mësimi që mund të nxjerrim prej tij e tejkalon Hansin, por adreson çështjet me të cilat të gjithë fëmijët herët a vonë do të përballen, pyetjet lidhur me dëshirën e prindërve dhe strumbullarët e trupit. Ka rëndësi të madhe, në trajtimet tona terapeutike me fëmijët të kemi dijeni për këto çështje.

**Geert Hoornaert**

### Bibliografia

- S. Freud, *Cinq Psychanalyses*, [Pesë psikanalizat], p. 177.

## PROGRAMI

**09h00 - 09h30 :** Regjistrimi i pjesëmarrësve

**09h30 - 09h40 :** Përshëndetje e pjesëmarrësve nga **Jolka Nathanaili- Penotet**,  
Presidente e Rrethit Lakanian Shqiptar dhe psikanalistit **Geert Hoornaert**

**09h40 - 12h00 :** Kumtesa *“Urgjenca e ankthit te fëmija”* nga **Geert Hoornaert**

**12h00 - 12h50 :** Pyetje dhe diskutime nga pjesëmarrësit

**12h50 - 13h20 :** *Pushim*

**13h20 - 15h00 :** Vijimi i kumtesës nga **Geert Hoornaert**

**15h00 – 15h30 :** Diskutime me pjesëmarrësit

**15h30 - 15h45 :** Prezantim i rastit klinik *“Cou(p)Cou(p)”* nga **Jolka Nathanaili-Penotet**

**16h00 - 16h30 :** Diskutim mbi punën me një fëmijë autik në shkollë, me **Kejvy Shmilli-n**

**16h30 - 17h00 :** Pyetje dhe diskutime mbi punën në institucione me pjesëmarrësit

**17h00 - 17h30 :** Përfundime dhe perspektiva klinike nga **Geert Hoornaert**